



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:033066
Datë: 16.05.2024
Numri i dokumentit: 05697291

C.nr.260/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtari Gëzim Shehu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit R.Ç. nga fshati Komuna e Prizrenit të cilin me autorizim e përfaqëson av. D.M. nga Prizreni, kundër të paditurës, "BKS" me seli në Prishtinë, me objekt të padisë kompensim i dëmit, me vlerë të kontestit 1,000.00 €, jashtë seance me datë **16.05.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M
-Në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia-

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit R.Ç. nga fshati Komuna e Prizrenit, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura "BKS" me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material për gjitha lloje, paditëses t'ia paguajë shumën prej 1.000.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 19.02.2021, e deri në pagesën definitive si dhe të detyrohet i padituri që ti paguajë shpenzimet procedurale.

II. Shpenzimet procedurale bien në barrë të paditësit.

A r s y e t i m

Paditësi R.Ç. nga Prizreni të cilin me autorizim e përfaqëson av.D.M. pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, më datë 22.02.2021, kundër të paditurës "BKS" me seli në Prishtinë, me objekt të padisë kompensim i dëmit, vlera e kontestit 1,000.00 €.

Paditësi - i autorizuari i tij përfaqësuesi av. D.M. me parashtrësën e datës 15.05.2024 , e ka njoftuar gjykatën se me të paditurën kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore , dhe mbi këtë bazë heqin dorë nga kërkesëpadia, duke u bazuar në nenin 149 të LPK-së.

Numri i lëndës: 2021:033066

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05697291

Në lidhje me shpenzimet procedurale gjykata vendosi që të njëjtat të bien në barrë të palës paditëse.

Andaj, gjykata bazuar në nenin 149.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), pa shqyrtim të mëtejshëm, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.260/2021, 16.05.2024

G j y q t a r i

Gëzim Shehu

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.